




Republika e Kosovës



Komuna Vushtri

Zyra e kryetarit të komunës

Në mbështetje nenit 13 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 ,nenit 12 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr.03/L-149 dhe në bazë të vendimeve nr.524/18, 525/18 dhe 526/18 të datës 17.04.2018, kryetari i komunës, shpall:

K O N K U R S

Për kryerjen e punëve me marrëveshje për shërbime të veçanta

Drejtoria për Shërbime Publike

Vendet e punës: Mirëmbajtës të lumit "Tërstena" dhe hapësirave tjera publike;

Numri i ekzekutuesve: Gjashtë (6);

Lloji i pozitës: Marrëveshje për shërbime të veçanta (kohëzgjatja 6 muaj);

Orari i plotë: 40 orë në javë;

Paga: 303.01 euro bruto

Qëllimi i vendit të punës: Mirëmbajtja e hapësirave publike, të cilat nuk janë përfshirë në kontratën kornizë.

Përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësi:

Mirëmbajtja e lumit "Tërstena";

Mirëmbajtja e hapësirave publike;

Bartja e inventarit dhe materialit zyrtar me rastin e kalimit përkatësisht transferimit nga objekti i vjetër i komunës në objektin e ri të komunës;

Punë të tjera fizike sipas nevojës së drejtorisë dhe organeve tjera të administratës së komunës.

Kualifikimi profesional, aftësitë, përgjegjësitë:

Përgatitja e mesme shkollore

Drejtoria për Arsim

Vendi i punës: Zyrtar për hartimin e projekteve kapitale për objektet shkollore;

Numri i ekzekutuesve: Një (1);

Lloji i pozitës: Marrëveshje për Shërbime të Veçanta (kohëzgjatja gjashtë (6) muaj);

Orari i punës: 40 orë në javë;

Paga: 423.85 euro bruto.

Qëllimi i vendit të punës: Hartimi i projekteve kapitale

Përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësi:

Punët që kanë të bëjnë me hartimin e projekteve kapitale, për objektet shkollore dhe objektet tjera sipas nevojës në kuadër të Drejtorisë për Arsim.

Kualifikimi profesional, aftësitë dhe përgjegjësitë:

Fakulteti teknik: preferohet drejtimi arkitekturës ose i ndërtimtarisë.

Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport

Vendet e punës: Ngjyrosja e hapësirave publike-muraleve në qytetin e Vushtrrisë;

Numri i ekzekutuesve: Katër (4);

Lloji i pozitës: Marrëveshje për shërbime të veçanta(kohëzgjatja një(1) muaj;

Orari i punës: 40 orë në javë.

Paga: 362.50 euro bruto.

Qëllimi i vendit të punës: Ngjyrosja e hapësirave publike- muraleve

Përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësi:

-Ngjyrosja e hapësirave publike- muraleve në qytetin e Vushtrrisë;

-Punë të tjera sipas nevojës së Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport.

Kualifikimi profesional, aftësitë dhe përgjegjësitë:

Fakulteti i arteve ose profesionist të tjerë me përvojë për këtë lloj të punës.

Konkursi mbetet i hapur 8 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informacionit publik.

Paraqitja e kërkesave:

Aplikacionet mund të merren në Zyrën e pranimi ose në faqen e internetit të komunës www.kk.rks-gov.net/vushtrri dhe pastaj dorëzohen në Zyrën e pranimi. Aplikacionit duhet t'i bashkëngjisin: Kopjen e vërtetuar të diplomës, kopjen e letërnjoftimit dhe certifikatën e lindjes, certifikatën që nuk është dënuar dhe nën hetime. Duhet të jetë banor i Republikës së Kosovës.

Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen. Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhjen e ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor. Për çdo informacion kandidatët mund të drejtohen në Njësinë e personelit (zyra numër 8), nr. i tel. 028-572-416.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri